



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1704/24 Datë: 20.08.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ.Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127 të mbajtur më datë 12.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit AAB kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - o *Banka, Financa dhe Kontabilitet BSc 180 ECTS, (R) me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik;*
 - o *Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve BA 240 ECTS, (R) me kuotën maksimumi 300 studentë për vit akademik;*
- II.** Riakreditohen programet e studimeve të Kolegjit AAB kampusi kryesor për periudhën pesë (5) vjeçare (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - o *Shëndeti Mendor MA 120 ECTS, (R) me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik;*
- III.** Akreditohet programi i studimit i Kolegjit AAB kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - o *Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve MA 60 ECTS (A) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
- IV.** Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- V.** Obligohet Kolegji AAB kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI.** Obligohet Kolegji AAB kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimin e bartësve aprovet me vendim nga KSHC.
- VII.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VIII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Faqe 1 nga 3

ARSYETIM

Kolegji AAB kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

| Nr. | Programi i studimit | Bartësit e programit |
|-----|--|---|
| 1. | <i>Banka, Financa dhe Kontabilitet BSc 180 R</i> | Floriqe Miftari Remzi Smajli Nakije Kida Besime Ziberi |
| 2. | <i>Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve BA 240 R</i> | Arberore Bicaj Mimoza Kamberi Hysen Kasumi Sevim Mustafa Saranda Shatri |
| 3. | <i>Shëndeti Mendor MA 120 R</i> | Mimoza Shahini Mimoza Telaku |
| 4. | <i>Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve MA 60 A</i> | Violeta Buza Lirika Bërdynaj Sylja |

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit në Kolegjin AAB kampusi kryesor, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit: *Natalie Gurvitsh, Horia Onita, Melita Kovacevic, Kristjan Kask, Gaga Gvenetadze, Stavros Parlaris, Elene Jiblatze,, Stefan-Marius Deaconu, Stavros Parlaris, Elene Jiblatze dhe Stefan-Marius Deaconu.*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Banka, Financa dhe Kontabilitet BSc 180***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 21.05.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2), Substancialisht katër (4) dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve BA 240***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 14.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht katër (4) dhe Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

Për arsye se fushat e standardeve që kanë të bëjë me stafin akademik dhe me përmbajtjen dhe procesin mësimorë nuk janë vlerësuar si plotësisht të përmbusura në programin *Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve BA 240 ECTS*, KSHC ka vendosur që kohëzgjatja e akreditimit për këtë program të jetë tri (3) vite.

3. **Për programin e studimit; Shëndeti Mendor MA 120**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 14.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht pesë (5) kurse Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
4. **Për programin e studimit; Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve MA 60**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 14.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht katër (4) dhe Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127 të mbajtur me datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Kolegjit AAB kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër si dhe dispozitave ligjore në fuqi, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

